

ADOPTIMI-MBROJTJE JURIDIKE PËR FËMIJËT PA PRINDËR DHE PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE SIPAS LEGJISLACIONIT TË RM-SË

Arta SELMANI*

Abstrakt :

Pas sjelljes së Ligjit mbi familjen në RM në vitin 1992, janë bërë plotësime dhe ndryshime të tij në zbatimin e masave juridiko-familjare për mbrojtjen juridiko-familjare të fëmijëve, mirëpo çështja e zbatimit të dispozitave ligjore sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore nuk është në nivel të duhur në Republikën e Maqedonisë, si nga ana e institucioneve kompetente gjithashtu edhe nga ana e personave tjerë përgjegjës për përkujdesjen e fëmijëve.

Roli i fëmijëve në përgjithësi, pa marrë parasysh statusin e tyre familjar duhet të jetë në nivel primar në një shtet juridik dhe në një shoqëri demokratike.

Qëllimi i punimit konsiston në:

- paraqitjen e rekomandimit për aplikimin e adoptimit si formë juridike më e përshtatshme për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore,
- aplikimin e masave juridiko-familjare dhe domosdoshmërinë e respektimit të të drejtave të garantuara me ligj nga organet kompetente dhe adoptuesit,
- domosdoshmërinë për sensibilizimin e ofrimit të shërbimeve nga institucionet kompetente për vendosjen e fëmijës në adoptim,
- realizimin e reformave për rregullim juridik serioz të të drejtave të fëmijëve të adoptuar,
- nevojën për përpilimin e një ligji special në këtë fushë të së drejtës familjare (mbrojtja juridike e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, me theks të veçantë mbrojtjen e fëmijëve të adoptuar),
- rëndësinë e respektimit të interesit të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore dhe mundësia që institucioni i adoptimit iu ofron fëmijëve dhe personave të interesuar të ushtrojnë të drejtën prindërore.

Korniza e pamjaftueshme ligjore në këtë pjesë të së drejtës, gjithsesi mund të plotësohet me anë të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit aktual mbi familjen në pjesën që u dedikohet të drejtave familjare të fëmijëve e sidomos fëmijëve të adoptuar, si dhe ligjeve tjera të veçanta që rregullojnë të drejtat e këtyre fëmijëve jashtë familjes. Mirëpo, përkundër ndryshimeve që mund të bëhen, procesi i përpilimit të një ligji special është më se i nevojshëm.

Është me rëndësi të veçantë çështja e miratimit dhe ratifikimit të mekanizmave ndërkombëtarë që rregullojnë adoptimin e fëmijëve pa prindër apo pa përkujdesje prindërore.

Rekomandimi deri tek qeveria, Ministria për punë dhe politikë sociale, Qendrat për shërbime sociale dhe institucionet tjera relevante, për disa ndryshime në këtë fushë të së drejtës, gjithsesi është pjesë e reformave ligjore dhe realizimi me përgjegjësi i këtyre reformave do të përmirësojë dukshëm nivelin familjar dhe shoqëror të fëmijëve.

Fjalët çelës: adoptimi-mbrojtje juridike më e përshtatshme, mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve të adoptuar, mbrojtja juridiko-sociale e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, përpilimi i ligjit special për rregullimin e mbrojtjes juridike fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore.

* Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni.